# DËSHMI ARKIVI

**A-459834**

VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kosova në Hagë, Shqipëria në 'Ballkanin e Hapur' dhe me 'Shtetin Bektashi'! |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/20/kosova-ne-hage-shqiperia-ne-ballkanin-e-hapur-dhe-me-shtetin-bektashi/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 20 shtator 2026, 11:53:54 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 20 shtator 2026, 11:52:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 20 shtator 2026, 11:51:00 UTC → 20 shtator 2026, 11:53:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | ab3fe7cf6e7ab1d6d213139336c62720fc9a3f8be6f1ee964a10404bc58b452a |
| TEKSTI | 7c91fe8c8812627e734f3131f2f40608965c116cf274de182e4af83978bf0a45 |
| PAMJA | efed3569572bc16be73efd1a18fd572d5256ce135dca86ebaf2b7b3dc59f9513 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 4ccafd6273caf7d2bf048b53a741640360e0f5f6e3eeb4365e449bf26970a201 |
| E MËPARSHMJA | b34558b28090cd441345a236fee9163f220f322a832e84a7ad08a068dc2b9bf3 |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4ccafd6273caf7d2bf048b53a741640360e0f5f6e3eeb4365e449bf26970a201`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

OPINION TË FUNDIT

# Kosova në Hagë, Shqipëria në 'Ballkanin e Hapur' dhe me 'Shtetin Bektashi'!

20/09/2026 13:52



**Nga Kim Mehmeti**

Kanë të drejtë ata që thonë se Qeveria e Kosovës nuk bëri sa duhet për t'i ndihmuar të akuzuarit në Gjykatën Speciale të Hagës.

Kanë të drejtë, sepse nuk mjafton vetëm t'ua paguash avokatët mbrojtës, por ka edhe shumë aktivitete të tjera që mund ta shpërfaqin të vërtetën për ta dhe për luftën çlirimtare të UÇK-së.

Por gjithë këta kritikues të qeverisë duhet t'ia bëjnë vetes një pyetje: Çfarë bënë ata që bota ta kuptonte se Gjykata e Hagës ishte një krijesë monstër që nuk mund të bënte asgjë më shumë sesa të prodhonte dënime monstruoze ndaj atyre që jetën e flijuan për lirinë e popullit të vet?

Pra, çfarë bënë për shembull OVL-ja apo PDK-ja për t'i ndihmuar të paraburgosurit në Hagë, përveç që organizuan protesta në Prishtinë e Tiranë, të cilat më shumë kishin karakter anti-VV sesa pro drejtësisë, si dhe deklaratave të "ganeve" e "vlorave" se i gëzohen kthimit të çlirimtarëve, por, siç duket, jo gjithaq pse ata do ta jetonin lirinë e merituar, por sepse – në emër të vuajtjeve të tyre – partia që ata drejtonin do të mund t'i fitonte zgjedhjet.

Ku ta dish, mbase OVL-ja dhe PDK-ja nuk organizuan asnjë tribunë që botës t'ia dëshmonin pastërtinë e çlirimtarëve, nuk financuan asnjë film dokumentar për ta afirmuar luftën e drejtë të UÇK-së, nuk stimuluan historian e shkrimtarët të shkruanin për luftën heroike të luftëtarëve të liris..., sepse prisnin që Grenelli t'u lajmërohej gjyqtarëve të Hagës e t'u thoshte: 'Mjerë ju nëse do të guxoni ta dënonin Xhorxh Uashingtonin shqiptar!'

Pra, ata mbase ishin të sigurt se, si gjithmonë, punën tonë do ta kryenin miqtë tanë perëndimorë.

Dhe të verbuar nga kjo bindje, ata edhe nuk e shihnin se Grenelli prej moti kishte kaluar në lobin proserb, se atë e kishte dekoruar Presidenti serb, se ai e luftonte Kurtin ngaqë besonte se ish-presidenti i akuzuar në Hagë ishte bashkëbisedues shumë më i lehtë për Vuçiqin.

E sa i përket Piktorit, atë nuk duhet pyetur se pse aq shumë u angazhuar që bota të kishte mirëkuptim ndaj shovinizmit serb e nuk bëri asgjë për të mirën e Kosovës, atë nuk duhet pyetur as pse partia e tij nuk e lejoi miratimin e rezolutës kundër gjenocidit serb mbi shqiptarët e Kosovës, sepse ai ishte i zënë me aktivitete shumë më 'strategjike', si për shembull me afirmimin e projektit ruso-serb – 'Ballkanin e Hapur', si dhe me realizimin e projektit cionist – me themelimin e 'Shtetit Bektashi'.

Dhe kur i merr dhe i analizon të gjitha këto paradokse shqiptare, përnjëherë e kupton se


## Kryesore



Foto/ Viktima që u ekzekutua njihej me emrin "Tani Ruzhdiut", plagosja e dy personave me armë zjarri në Sarandë solli sagën e hakmarrjes
10:53

Vrasja e 44-vjeçarit dhe plagosja e kalimtarit në Sarandë, reagon Policia: Janë ngritur pika kontrolli në drejtim të Vlorës dhe Gjirokastrës
10:58

Kontrabandë mallrash nga Greqia, arrestohen 2 persona në Gjirokastër, sekuestrohen mbi 22 mijë euro dhe 100 steka cigare
09:44

Dy gjermanë bëjnë "shaka" në Luvër, ngjisin dy piktura me shirit pranë Mona Lizës, por… përfundojnë në komisariat
22:55

Lazio nuk fal në transfertë, Zaccagni dhe Noslin ngjitin Gattuso-n në majën e Serie A
22:43

## Më të lexuarat

Bordi i Transparencës ndryshon çmimet e karburanteve, nafta dhe benzina pësojnë rënie

U tallën me Çerçiz Topullin, jep dorëheqjen kreu i Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastër

Fredi Beleri "mburr" deputetin e Agimit të Artë dhe sulmon drejtësinë greke, tërheq deklaratën pas reagimeve të forta nga PASOK

U vra me armë zjarri në rrugë, ja kush është viktima në Sarandë, rezulton i arrestuar në 2025

Spektakël i dyshes Salah-Muçi dhe Trabzonsporit, kampionët e Galatasarayt pësojnë disfatën e parë

Sapo ishte ulur për kafe në një lokal, 44-vjeçari tentoi t'i largohej me vrap autorëve, por u vra në mes të rrugës

Detajet/ Vrasje me armë zjarri në Sarandë, plagoset dhe një kalimtar. Viktimës iu zu pritë nga autorët

Foto/ Viktima që u ekzekutua njihej me emrin "Tani Ruzhdiut", plagosja e dy personave me armë zjarri në Sarandë solli sagën e hakmarrjes

Dhe kur i merr dhe i analizon të gjitha këto paradokse shqiptare, përnjëherë e kupton sa të paktë janë projektet shqiptare pro të mirës së vet dhe sa të shumtë janë projektet e tyre strategjike për zhbërjen e shqiptarisë, e ku nuk mungojnë as ato me shenjën fetare, siç është për shembull ai i antishqiptarëve të 'Lëvizjes së Deçanit', që donë të na bindin se fetë, e jo atdhetaria e patriotizmi, e forcojnë dhe e dobësojnë boshtin kurrizorë të shqiptarisë?

Pra, e kupton se perversiteti ynë ka përmasa monstruoze dhe se ne aq shumë jemi armiqësuar me vetveten, sa nuk kemi më nevojë për armiq të jashtëm.

**Top Channel**


Angli/ Katër 17-vjeçarë shqiptarë të "zhdukur", kërkohet ndihma publikut për t'i gjetur (Fotot)

Dy Gjermani në zgjedhje/ Mrekullia ekonomike e Mecklenburgut dhe kriza e strehimit në Berlin, çfarë do të përcaktojë beteja zgjedhore e të dielës


## Opinion »



Ushtritë e tastierës përkundrejt interesit Kombëtar

19/09 15:34



"Shteti që mëson"

19/09 12:09



Top Poll: Zhgënjim i madh i shqiptarëve nga Gjykata e Hagës

18/09 16:51



"Nga kodi i etikës te algoritmi"

18/09 12:51



Pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve: Kush e paguan moszbatimin e Kushtetutës?

17/09 16:08



Jo në emrin tim!

17/09 15:16

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News – Vrasja në Sarandë, pika kontrolli në Kardhiq për kapjen e autorëve



Top News – Pakt i ri për komunitetet lokale/ Turizmi, Rama: Fond për shoqatat që mbrojnë territorin



Top News – Makina përfundon në kanal/ Aksident në aksin Fier–Seman, drejtuesja e mjetit në spital



Top News- Arabia nën sulm, flakë e tym mbi Riad / Huthit sulmojnë kryeqytetin saudit, dronë e raketa



Top News – Turqia 'hyn në luftë' me Huthit / Në ndihmë të Arabisë Saudite sipas paktit të mbrojtjes



Top News – Media persekutoi Harry-n dhe Meghan-in / Vëllai i Dianës bën krahasime me princeshën




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.